



RREGULLORE NR. 2005/30

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kapitullin 8 dhe nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 27 maj 2005 lidhur me Ligjin mbi Odën Ekonomike të Kosovës të miratuar nga Kuvendi më 20 maj 2005,

Duke vënë re se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi Odën Ekonomike të Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/7) që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që:

- (a) Termi “Gjykatë nderi” kudo që paraqitet në tekstin e Ligjit të zëvendësohet me “Këshill nderi”;
- (b) Në nenin 17 (g), termi “gjyqtarë” të zëvendësohet me “anëtarë”;
- (c) Neni 25.3 të ndryshohet si vijon: “Këshilli i nderit vendos për dënimet administrative jomonetare, për masat disiplinore, cakton përgjegjësitë dhe publikon të dhënat për vendimet e marra në pajtim me Kartën” dhe

- (d) Termat “kombëtar”, “shtet” dhe “Kosova” kudo që paraqiten në tekstin e Ligjit të zëvendësohen me “Kosovo” (në anglisht).

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 2 qershor 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm